



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 15, datë 08.11.2019

PËR

**MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: “ZGJERIM I RRJETIT TË  
KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE TË OPERATORIT VODAFONE ALBANIA,  
NËPËRMJET SHTIMIT TË ANTENAVE PËR 3 STACIONE BAZË TË EMËRTUARA:  
1193 FRESKU 2, 1272 NEW RING ROAD 4 DHE 1296 FARKA 2, ME VENDNDODHJE  
NË BASHKINË TIRANË”**

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe VKM-së Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të shoqërisë “Vodafone Albania” sh.a, Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: “për 3 stacione bazë të emërtuara: 1193 Fresku 2, 1272 New Ring Road 4 dhe 1296 Farka 2, me vendndodhje në Bashkinë Tiranë”, me zhvillues shoqërinë “Vodafone Albania” sh.a.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumentet i Lejes së Ndërtimit i jepen subjektit zhvillues veçmas për secilin prej 3 stacioneve bazë, vetëm pas:
  - a. Për stacionin “**1193 Fresku 2**”:
    - pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Tiranë.
  - b. Për stacionin “**1272 New\_Ring Road 4**”:
    - pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Tiranë.
  - c. Për stacionin “**1296 Farka 2**”:
    - pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Tiranë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI  
EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

